

Fjalë të Mëdha - Pjesa 2

Të Rrimë Zgjuar

Mirë se erdhe në festimin e kishës sonë.

Mesazhin sot do ta filloj me një pasazh shumë interesant. Jemi në pjesën e dytë të serisë "**Fjalë të Mëdha**". Para se të shikojmë se cilat janë fjalët për sot, le të lexojmë së bashku pasazhin:

Veprat e Apostujve 20:7-9 *'Ditën e parë të javës, kur ishin mbledhur dishepujt për të thyer bukën, Pali, i cili duhet të nisej të nesërmen, bisedonte me ta dhe e zgjati fjalën deri në mesnatë.*

Dhe në sallën ku ishim mbledhur kishte shumë llamba.

Një djalosh me emër Eutik, që ishte ulur në parvazin e dritares, e zuri një gjumë i rëndë; dhe, ndërsa Pali e çoi fjalën gjatë, e zuri gjumi, ra nga kati i tretë poshtë dhe e ngritën të vdekur.'

Shokë, ky është rasti i parë i dokumentuar kur dikush e ze gjumi në kishë, dhe nuk ka qenë rasti i fundit. Djaloshi quhet Eutik, dhe ai ka lënë pas shumë shokë që i zë gjumë në kishë.

Gjumi është i nevojshëm apo jo? Ne kalojmë 1/3 e jetës duke fjetur. E bukura e gjumit është se, kur ti je në gjumë, nuk e kupton që po fle.

(Shembull: Babain im e zinte gjumi gati çdo mbrëmje në divan. Sa të kishte ngrënë darkë, ulej në divan përpara televizorit dhe e zinte gjumi. I thoshim, "O ba, mos fli, ose shko të flesh në krevat." Ai trembej dhe thoshte, "Ah, jo, jo, nuk po fle, po shoh televizor.")

Ai që fle, nuk e kupton që po fle.

Ka njerëz që i zë gjumi kudo.

Ushtarët, gjatë ditës bëjnë stërvitje, ndërsa natën kanë shërbim roje. Kuptohet që në darkë janë të lodhur, sidomos në shërbimin e dytë pas orës 12, dhe i zë gjumi sa herë që ulen diku. Madje, ushtari mund të flejë edhe në këmbë.

Ka njerëz që mund të flenë kudo, madje edhe në kishë. Por ka edhe disa që, nëse nuk janë në krevat, nuk i zë gjumi. Madje edhe krevati duhet të jetë i rregulluar shumë mirë që ata të flenë.

Të gjithë flemë dhe kemi dëshirë të flejmë, dhe ndonjëherë gjumi na vjen pa e kuptuar. Veprat e Apostujve përshkruajnë fillimin e kishës së parë. Kisha filloi me shumë vrull, dhe madje gjejmë që Apostulli Pali, predikuesi më i madh pas

Jezusit, predikonte një grup besimtarësh, dhe njërin prej tyre e zë gjumi gjatë predikimit të tij.

Kjo më qetëson pak. Nëse dikë mund ta zërë gjumë gjatë predikimit të Palit, ndoshta është normale që të ndodhë edhe kur predikoj unë.

Pali ishte në qytetin Troas dhe kjo ishte mundësia e tij e fundit për të folur me të krishterët atje. Ata u mbledhën në shtëpinë e një njeriu në katin e tretë. Një shtëpi tre-katëshe në shekullin e parë? Më duket se ka qenë shtëpia e më të pasurve të qytetit.

Pali po predikonte Lajmin e Mirë të Jezus Krishtit: Ai erdhi, vdiq në kryq për mëkatet tona, dhe u ringjall pas tre ditësh. Shtëpia ishte plot. Ishte vapë. Në **Veprat e Apostujve 20:8** thuhet: *"Dhe në sallën ku ishim mbledhur kishte shumë llamba."*

Pse u përmend ky detaj? Kati i tretë ndihmonte që të gjithë të mund të shihnin nga larg, duke e bërë më të lehtë të vëreje se ndodhte diçka aty lart. Një grumbull njerëzish ishin mbledhur dhe po flisnin për Jezusin, Birin e Perëndisë që u ringjall.

Eutiku ishte ulur në pravazin e dritares. Ka mundësi që ishte pak freskët aty, sepse dritarja krijonte korent. Njerëzit po e dëgjonin Palin me shumë interes ndërsa ai tregonte për përpjekjet e tij për të shpërndarë lajmin e mirë në çdo cep të Perandorisë Romake dhe për të gjitha persekutimet që kishte duruar.

Në ato kohë, predikuesit flisnin gjatë; nuk ishte si tani që nëse kalon 30 minuta ke folur shumë. Pali predikonte për orë të tëra. Aty thuhet se Pali e kishte çuar fjalën gjatë, deri në mesnatë. Ndërkohë, Eutiku, që mund ta quajmë Tiku, po e merrte gjumi, po dremiste.

Tiku humbi ekuilibrin dhe ra nga kati i tretë. Fluturimi nga kati i tretë ka ndodhur pas disa sekondash, kohë e mjaftueshme për të thënë diçka ose për të kuptuar se ishte duke rënë. Kur arritën poshtë, njerëzit e panë dhe thanë se kishte vdekur.

Pali e ndaloi mesazhin, zbriti poshtë në katin e tretë, e përqafoi Eutikun dhe e ringjalli nga vdekja. Pastaj e ngjiten lart përsëri. Dhe Pali vazhdoi të predikonte për disa orë të tjera deri sa ra drita. Pra, filloi predikimin në orën 6 të mëngjesit dhe përfundoi në orën 6 të mëngjesit. Nuk ka faj Eutiku që e zuri gjumi në kishë.

Aaaa, është e dokumentuar, personi i parë që e zuri gjumi në kishë. Edhe sot ka shumë njerëz në kishë që flenë. Jo flenë fizikisht – në kishën tonë nuk flenë shumë, mund të ndodhë shumë rrallë. Por flenë në një sens tjetër; janë të

përgjumur frymërisht, janë të përgjumur moralisht dhe nuk kapin mundësitë që iu jep Perëndia. Janë të përgjumur dhe nuk kuptojnë qëllimin dhe planin që ka Perëndia për jetën e tyre. Prandaj, dua të sfidoj me këtë mesazh sot, në serinë "Fjalë të Mëdha", dhe fjalët sot janë: **Zgjuhu nga Gjumi!**

Të lutem, ndërsa po dëgjon mesazhin, mos mendo "Ky mesazh do ishte i mirë për filanin, atij i duhet, asaj i duhet, sepse ka marrë kot, atij që bënte si i mirë i duhet, se është bërë garip ai."

Jo, jo, mendo për vete së pari. Sepse të gjithë na zë gjumi, dhe nuk e kuptojmë që po flemë. Ka gjasa që ti je përgjumur; nuk e mban mend kur ke kaluar kohë me Perëndinë. Nuk e mban mend ku e ke Biblën. Nuk e mban mend kur ke bërë diçka me atë që të ka thënë Perëndia. Nuk e mban mend ç'ditë është sot, sepse të duken të gjitha ditë pushimi, si fundjavë e pafund.

Vargu që është super për të të zgjuar frymërisht është:

Efesianëve 5:14 *'Prandaj Shkrimi thotë: "Zgjuhu, ti që fle, dhe ringjallu prej së vdekurish, dhe Krishti do të shndrisë mbi ty".'*

Oooo, paska varg zgjimi në Bibël?

Po, alarmi është 5:14 dhe ja çfarë thuhet te vargjet 15-17, arsyeja pse duhet të rrimë zgjuar.

Efesianëve 5:15-17 *'Kujdesuni, pra, që të ecni me kujdes dhe jo si të marrët, por si të mençurit, duke e shfrytëzuar kohën, sepse ditët janë të mbrapshta. Prandaj mos u bëni të pakujdesshëm, por kuptoni cili është vullneti i Zotit.'*

Shkrimi thotë, nëse jemi në gjumë, nuk do të kuptojmë cili është vullneti i Perëndisë për ne. Nëse jemi në gjumë, s'do të kuptojmë jetën siç duhet. Nuk do të kuptojmë se çfarë të bëjmë. Nëse nuk ecim me kujdes, nuk do të marrim vendimet e duhura. Do të jemi duke ecur përgjumësh në jetë. Si quhet kur çohesh dhe ecën në gjumë? **Somnambul**. Ashtu ndodh nëse nuk je zgjuar; jeta do ecë dhe ti akoma nuk ke kuptuar përse të ka sjellë Perëndia në këtë botë.

Ka raste kur ti takon dikë që ka vite që e njeh Zotin dhe e sheh që ai/ajo po jeton në mëkat. Çfarë do të thotë kjo? Ka qenë në gjumë gjithë këtë kohë dhe as që ka kuptuar se çfarë dëshiron Perëndia nga ai/ajo.

Po ti a je në gjumë?

Në Gjumë Frymëror

Ndoshta ti që po dëgjon që je në gjumë frymëror; as nuk e njeh fare Perëndinë dhe as nuk e di që ka një Perëndi. "Mjafton të jem një djalë i mirë, një vajzë e

mirë—kaq më duhet.” Por, nuk mjafton vetëm të jesh i mirë, sepse asnjë njeri nuk është plotësisht i mirë. Edhe më i miri bën mëkate. Bibla thotë që paga e mëkatit është vdekja. Bibla thotë që nuk e fitojmë qiellin dhe aprovimin e Perëndisë vetëm sepse jemi të mirë.

(Shembull: Po i flisja një djali për Jezusin dhe për nevojën që çdo njeri ka për Shpëtimtarin e jetës së tij, që ka vdekur në kryq për të na pajtuar me Perëndinë. Nëse nuk jemi të pajtuar me Të, kur të jemi para Perëndisë një ditë, Ai do na pyesë dhe do i japim llogari për mëkatet tona. Nëse nuk ka paguar dikush për ty, duhet të paguash vetë për to, sepse paga e mëkatit është vdekja.

Ai dukej qartë që nuk donte fare të dëgjonte. Fjalët po i hynin në një vesh dhe dilnin nga tjetri. Edhe nga fytyra e dalloje që po flinte, dhe thashë me vete, “bjeri pastor, bjeri, se po i bie mirë.” Nuk kishte asnjë interesim për këto gjëra. Po flinte frymërisht, por as që donte të zgjohej.)

A je ti me këtë idenë: “Po bëra të mira, do të më marrë Zoti me të mirë.”

Nuk mjaftojnë të mirat tona.

A të them diçka të shpifur? Bibla thotë, te Isaia, se veprat tona, punët tona më të mira, ato të mirat fare-fare, janë si rroba e ndotur përpara një Perëndie të shenjtë.

E di cili është kuptimi për rrobë e ndotur? Rroba që gratë përdornin për të muajshmet e tyre. Ta shpifa? S’ka gjë, sepse aq të mira janë veprat tona më të mira përpara një Perëndie të përsosur.

Prandaj, nëse kishe ndonjë shpresë për veprat e tua të mira, hiqe atë opsion. Sepse herët apo vonë do ta kuptosh se nuk pajtohesh me Perëndinë përmes përpjekjeve të tua. Është vetëm ajo që bëri Jezusi në kryq për ty, për mua. Ai pagoi për mëkatet tona për të na dhënë falje dhe për të na bërë të drejtë para Tij.

Kjo është e vetmja mënyrë, dhe kur ti beson në atë që bëri Jezusi për ty dhe e pranon në jetën tënde, jeta jote bëhet e re, e kaluara pastrohet, e tashmja merr kuptim dhe e ardhmja sigurohet.

A e ke marrë këtë vendim? Nëse jo, sot është dita, mundësia më e mirë për ty. Sot është dita e shpëtimit. Dhe unë mund të të drejtoj në një lutje të thjeshtë nëse nuk e ke marrë këtë vendim, shumë shpejt.

Pasi të kesh marrë vendimin, do të fillosh të ecësh me Zotin, të dëgjosh fjalën e Tij, të lexosh Biblën dhe të kuptosh se çfarë i pëlqen Atij. A po ecën me Zotin tani, apo të ka zënë gjumi? A po e dëgjon zërin e Tij?

Satani ka qejf që të jemi të përgjumur; madje ai del vullnetar për të na kënduar ninulla që të na vërë në gjumë lehtë. Ai ka qenë muzikant i mirë, e ka në CV dhe të mashtron me lezet. Përgjumja do të ndalojë rritjen tënde.

Nëse e fik alarmin dhe rri në gjumë, ti nuk do të arrish maksimumin tënd, qëllimin, apo vullnetin e Perëndisë për jetën tënde.

Djalli do të donte që të flinim gjumë. Shhhh, mos bëj zhurmë se po flenë. Po fle kisha jonë, po fle kisha e Perëndisë në Shqipëri.

S'ka gjë, le të flenë pak, se kanë ndenjur vonë deri në 3 të mëngjesit dhe u bën mirë gjumi që rriten.

Le të flenë, djalli thotë: 'Fli, se të këndoju unë ninulla; fli, bir; fli, gocë; fli, të keqen djalli ooo, fli edhe sot se nuk bëhet nami; fli se ka të tjerë rreth e rrotull; fli se çfarë mund të bësh ti, je vetëm një person. Flini se çfarë të bëni ju, jeni vetëm një kishë; fli se çfarë mund të bëjnë të krishterët, se 33% e botës janë, thjesht 2.5 miliard njerëz.'

A po fle ti, apo po e kap planin dhe vullnetin e Perëndisë për jetën tënde? Nëse do të ishim zgjuar plotësisht, do të kuptonim se sa i mirë është Perëndia, sa i madh është Ai. Kur të jesh zgjuar, do të kuptosh sesa shumë bekime ka Ai për jetën tënde, sa favore, sa mundësi. Perëndia dëshiron që jeta jonë të jetë e gjallë, plot aventurë, bukuri, zjarr dhe pasion.

Djalli thotë: 'Rri rehat, fli gjumë, se ka të tjerë. Do dalësh ti; ti je e lodhur, ke ngrënë pesë herë sot. Fli gjumë, kthehu dhe njëherë nga ana tjetër.'

Kurse Perëndia thotë: 'Zgjohu,' si ishte vargu:

Efesianëve 5:14 *'Prandaj Shkrimi thotë: "Zgjohu, ti që fle, dhe ringjallu prej së vdekurish, dhe Krishti do të shndrisë mbi ty".'* Ra alarmi, alarmi është vendosur për në 5:14. Disa flenë dhe nuk duan t'ia dinë për Perëndinë.

Nuk duan të mbjellin

Disa flenë dhe nuk duan të mbjellin në arën e Perëndisë. Jeta jote, jeta ime është si një farë. Bibla flet shumë për parimin e mbjelljes dhe korrjes. Nëse mbjell misër, nuk do të korrësh portokalle. Nuk ndodh kështu sepse është parimi i mbjelljes dhe korrjes.

Ato që do të mbjellësh, ato do të korrësh. Nëse po fle dhe nuk mbjell, nuk do të kesh shumë për të korrur. Koha më e mirë për të mbjellë diçka është sot. Nesër, nuk e dimë se çfarë do të ndodhë. Kemi mundësinë sot për të bërë diçka për Perëndinë.

Të krishterët, thuhet te Veprat 20, mblidheshin ditën e parë të javës, që ishte e diela, dita kur u ringjall Jezusi, dhe kjo ishte dita e parë e javës për ta. Ti po mbjell kur ditën e parë të javës ia përkushton Perëndisë duke marrë pjesë në festimin e kishës dhe duke pranuar një fjalë nga Perëndia për javën që vjen.

Ti mbjell kur shërben duke u lutur për dikë, duke inkurajuar dikë. Ti mbjell kur, në këtë kohë, të kam nxitur të bësh minimalen, por ama të bësh diçka.

Kur dikush u pyet se çfarë do të bënte nëse do të dinte se bota do të përfundonte nesër, ai tha: 'Sot do të mbillja një pemë. Sot do të bëja diçka.' Nuk e dimë çfarë do të ndodhë nesër ose javën që vjen, por kemi të sotmen, dhe sot unë do të bëj minimalen për dikë.

Ti mbjell kur jep 1/10 për shërbesat e kishës. Është mbjellje për të dhënë fryt për Mbretërinë e Perëndisë. Perëndia ka premtuar se kur ti jep, Ai do të qortojë të ligun dhe nuk do të ketë ndikim në jetën tënde. Kjo është e shkruar te Malakia 3.

Në logjikën njerëzore, kur jep, mund të ndihesh se të ngelet më pak. Por në ekonominë e Perëndisë, kur ti jep, ti po mbjell për të korrur mbrojtje dhe bekime nga Perëndia. Perëndia nuk ka nevojë për ato, ti ke nevojë për frytet e mbjelljes tënde dhe mbrojtjen e Tij.

Zgjohu dhe shndrit! E diela është dita e parë e javës, kur festojmë sepse Jezusi është i gjallë dhe dashuria e Perëndisë është e re. Ti je lider; mos u përgjum në këtë kohë, ji aktiv. Satani dëshiron që të flesh, të marrësh gjumë të qetë, duke thënë: 'S'ka gjë, se aty është.' "Po se bëra unë, do ta bëjnë të tjerët." Jo, jo, ti ke pjesën tënde; zgjohu dhe shndrit!

Kur të jemi përballë Perëndisë, do të na bëjë dy pyetje:

1) 'Çfarë bere me Birin Tim? A besove në Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar?'

2) 'Çfarë bere me dhuntitë, talentet, pasionet dhe përvojat që të dhashë?'

"Çfarë bëre te kisha ku të vendosa Unë? A fjete gjumë?"

Unë e di që asnjë nga ju nuk do të jetë i tillë. Sepse ti je ndryshe; ti mezi po e pret fjalinë e parë që do të thotë Perëndia: '**Të lumtë, shërbëtor dhe besnik.**' Ti nuk fjete gjumë; ti e ke kapur çdo moment.

Mos i lër aftësitë dhe talentet e tua të përgjumen. Ti je një gjeni, dhe unë jam një gjeni. Si e di këtë? Sepse ti je krijuar sipas imazhit të Perëndisë. Perëndia është krijues, dhe ti gjithashtu je krijues; krijimi është brenda teje. Ti je një gjeni, një kryevepër e Perëndisë.

Perëndia ka vendosur në ty gjithçka që të nevojitet për të shndritur. Me ato që ke, ti mund të bësh diçka për dikë në emrin e Jezusit. Ti mbjell çdo herë që thua diçka, çdo herë që bën diçka. Dhe Perëndia e bën që mbjellja të shumohet.

Sot, më shumë se kurrë, është koha për të mbjellë. Lutja ime është që mbjellja jote të japë 100-fish, siç i ndodhi Isakut:

Zanafilla 26:12 *'Isaku mbolli në atë vend dhe po atë vit korri një prodhim njëqind herë më të madh; dhe Zoti e bekoi.'*

Si mund ta ndikosh botën tënde? Duke mbjellë me jetën tënde. Perëndia do ta shumfishojë atë që ti mbjell.

Pra, dikush mund të jetë në gjumë, sepse nuk e njeh Perëndinë. Dikush tjetër mund të jetë në gjumë dhe nuk po mbjell. E fundit...

Dikush mund të jetë në gjumë dhe nuk po rritet në Zotin.

Çfarë do të thotë të rritesh dhe të piqesh në Zotin? Do të thotë të njohësh, fillimisht të kuptosh Biblën dhe Fjalën e Perëndisë. Por më e rëndësishme është të besosh dhe të zbatosh atë që di.

Një nga vargjet e mia të preferuar kur mendoj për ty si lider dhe për rritjen tënde shpirtërore është:

Jeremia 3:15 *'Do t'ju jap pastaj barinj sipas zemrës sime, që do t'ju kullosin me dije dhe dituri.'*

Kështu thotë Perëndia për barinj të drejtuesit: të kenë zemrën si zemra e Perëndisë, të jenë të mbushur me njohuri dhe të kuptuar, ta duan shumë Zotin, të kenë njohuri dhe dije në lidhje me Shkrimin, të kenë dituri mbi se si Shkrimi lidhet me jetën e përditshme.

Të kuptuarit vjen kur e zbaton atë që di. Nëse ti thua se je pjesë e kishës, kjo do të thotë se je duke bërë diçka këtu, në një nga shërbesat. Nuk do të thotë thjesht se ke emrin aty. Përndryshe, po fle. Dhe i ligu dëshiron që të flesh.

Martin Luteri, reformatori ynë, thuhet se pa një ëndërr për ferrin. Në ëndërr, ai ishte në ferr dhe djalli ishte ulur në një fron, ndërsa demonët vinin dhe i raportnin.

Një demon i tha Satanit, 'Satan, dua të tregoj diçka për disa të krishterë që ishin nisur për në rrugë me një karvan dhe unë nxita disa tigra që iu sulën dhe i vranë.'

Satani i tha, 'O budalla, qenke lodhur kot. Ata tani janë me Jezusin. Nuk më the ndonjë gjë interesante; ik, ik, nuk paske bërë ndonjë gjë të madhe.'

Pastaj erdhi një demon tjetër dhe i tha, 'Ishte një grup që po shkonte në mision në një vend ku nuk kishte shkuar ungjilli. Unë shkaktova një erë të fortë sa varka u përmbys dhe ata u mbytën.'

Satani i tha, 'Prapë me këto gjëra. Unë nuk dua trupin e tyre fizik; unë dua shpirtin e tyre.'

Më pas erdhi një demon i mençur dhe i raportoi Satanit, 'Unë kam disa vjet që po mundohem të ve në gjumë filanin dhe më në fund e zuri gjumi.'

Sa e dëgjoji këtë, Satani kërkoi që gjithë ferri të bertiste me të madhe për të përgëzuar demonin e zgjuar.

Mos fli gjumë, çohu dhe shndrit. Çohu me fuqinë dhe hirin që të jep Perëndia.

Le të lutemi.